



**KONTRATE**  
(Për transferimin e aksioneve të shoqërisë "A.S.K" Sh.a)

Sot në Tiranë me datë 20.02.2010 (dymijë e njëzet, përpara meje noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme:

**SHITESI:** Z. Andi Kume, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 11.12.1983, mbajtës i pasaportës nr. Z1472536, titullar i 67 aksioneve që përfaqësojnë 67% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

**Dhe**

**BLERESI:** Z. Hamdi Pasha, shtetas shqiptar, lindur në Thumane, Krujë, më 05.03.1966, mbajtës i pasaportës nr. Z1366235, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

**MEQENESE**

- Shitësi zotëron 67 aksioneve të shoqërisë të cilat përbejnë 67% të kapitalit të Shoqërisë "A.S.K" Sh.a (Shoqëria), shoqëri aksionare e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS - K82109004K.
- Shoqëria ka një kapital të regjistruar në vlerën Lek 2.000.000 (dy milion) i ndare në 100 (njëqind) aksione me vlerë nominale 20.000 (njëzet mijë) lek secili;
- Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi t'i shesë Blerësit 22 aksione që përbejnë 22% të kapitalit të Shoqërisë;
- Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi aksionet e specifikuarra me sipër;
- Aksionet shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë.

Meqenëse ekzistojnë kushtet me sipër, palët bien dakord për sa me poshtë vijon:

**1. Objekti i Kontratës**

Sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë, Shitësi transferon tek Blerësi dhe ky i fundit blen nga Shitësi 22 (njëzet e dy) aksione që përbejnë 22% të kapitalit të Shoqërisë;

**2. Çmimi i shitjes**

Aksionet shiten (transferohen), kundrejt vlerës së tyre nominale prej Lek 20.000 (njëzet mijë) lek, për çmimin total prej 440.000 (katerqind e dyzetë mijë), i cili është paguar plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

**3. Transferimi i pronësisë mbi aksionet**

Pronësia mbi aksionet transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

**4. Te ndryshme**

Pas transferimit të pjesëve të kapitalit tek Blerësi, behet pronar i ligjshëm i 22 aksioneve që përbejnë 22% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë dhe ushtron të gjitha të drejtat që ligji i njeh zotëruesit të aksioneve të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate si nga pikëpunja e ushtrimit të së drejtës së votës dhe të pjesëmarrjes në shpërndarjen e fitimeve. Shitësi humbet të gjithë të drejtat që buronin nga aksionet e shitura dhe deklaroi se nuk ka pretendime të asnjë lloji ndaj shoqërisë dhe/ose aksionareve të saj.

**5. Baza Ligjore**

Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore të cilës i behet referim në këtë kontratë.

Kjo kontratë pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet në përputhje me vullnetin e lire e të plote të palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time në katër kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.

**SHITESI**

**BLERESI**

Andi Kume

Hamdi Pasha



NOTERI